


REPUBLIKA E SHQIPERISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE

Nr.Rregj.Them 192
Data e regjistrimit 12.03.2012

Nr.Vendimi 192
Data 20.04.2012

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE E PËRBËRË PREJ
GJYQTAR ALBERT SPIRO

Asistuar nga sekretaria Marjanela Beshtika më datë 20.04.2012 perfundoi se shqyrtuari ne seance gjyqesore cështjen me Nr. Rregjistri 192 që i përket :

KËRKUES [redacted] biri [redacted] datelindjes [redacted]
[redacted] lindur dhe banues ne Vlore ,me shtetesi shqiptare.

Mbrojtur ne gjykim nga Av. Ardian Dauti i zgjedhur prej tij.

OBJEKTI Kerkohet kthimi i sendit te sekuestruar ,autoveture e markes BMW [redacted] pa targa me nr shasie [redacted] sekuestruar shtetas [redacted] me procesverbalin e dates 30.05.2011 te o.p.g [redacted]

BAZA LIGJORE Neni 217.218/1/2/3 e vijues te Kodit te Procedures Penale

ME PJESËMARRJEN Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
Përfaqesuar nga prokurori [redacted]

Ne perfundim te gjykimit pjesemarrsit kerkuan:
Av mbrojtjes-Pranimin e kerkeses.
Prokurori- Rrezimin e kerkeses

Gjykata pasi u njoh me kerkesen ,degjoi prokurorin,shqyrtoi provat shkresore,degjoi kerkimet perfundimtare te pjesemarrsesve ne gjykim dhe pasi e shqyrtoi ceshtjen ne teresi

VEREN

Kërkuesi [redacted] ne kërkesën drejtuar Gjykatës,kërkon kthimin e sendit te sekuestruar,autoveture e markes BMW 730 pa targa me nr shasie [redacted]

██████████ sekuestruar me procesverbalin e dates 30.05.2011 te o.p. ██████████

Kerkuesi pretendoi para gjykates se:

Ka blere nga nje automjet nga nje shtetas me emrin ██████████ dhe i ka dhene 6000 euro kapar duke u garantuar se nuk do te kishte probleme pronesie.

Ka levizur i qete me te pa pasur probleme me date 30.05.2011 ndalet nga sherbimet e policise rrugore per tu puetur ne lidhje me dokumentacionin e automjetit dhe ai i paraqet dokumentacionin qe dispononte, por ata e shoqerojne ne Drejtorine e Policise per te bere verifikimet.

Pas verifikimeve i komunikojne se makina do te bllokohet pasi ka probleme pronesie apo shasie.

Me procesverbalin e dates 30.05.2012 eshte vendosur sekuestrimi i automjetit me arsyetimin se jane duke u zhvilluar hetime per vepren penale te trafikimit te mjeteve motorike.

Megjithese ka kaluar rreth nje vit akoma nuk kane perfunduar hetimet.

Aktualisht automjeti eshte jashte perdorimit dhe ne gjendje te keqe dhe lenia akoma ne kete status fizik do te sjelle degradimin e mtejshem fizik te tij deri ne kushtet e paperdorshmerise se plote.

I eshte drejtuar Prokurorise se rrethit Gjyqesor Vlore ne baze te nenit 217 te K.Pr.Penale, por akoma prokurori nuk i ka kthyer asnje pergjigje.

Ne keto rrethana ne baze te nenit 218 te K.Pr.Penale po i drejtohet Gjykates per kthimin e ketij automjeti.

Per te provuar pretendimet e tij kerkuesi paraqiti si prova kerkesen drejtuar Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore, dy flete te dokumentacionit automjetit dhe nje dokument akt shitje automjeti te perkthyer nga gjuha gjermane.

Prokurori u shpreh per rrezimin e kerkeses. Rezulton se eshte rregjistruar procedimi penal per vepren penale te parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal. Eshte kryer akt ekspertimi i shasise se ketij automjeti dhe ka rezultuar se ka nderhyrje ne shasi.

U eshte derguar leterporosi autoritetve gjermane dhe deri ne kete moment nuk ka ndonje kthim pergjigje per kete fakt.

Nga kerkuesi ██████████ nuk disponohet asnje dokument per pronesine i automjetit i cili ka rezimuar i vjedhur ne Gjermani dhe eshte futur ne Shqiperi me date 09.12.2010. Ne keto rrethana ata nuk mund te disponojne ne lidhje me lenien ne ruajtje te automjetit kerkuesit sepse ka dyshime qe ky mjet nuk i perket atij.

Nga ana e prokurorit u paraqiten disa prej akteve qe i perkasin procedimit penal Nr 633 te Vitit 2011 si urdhri i rregjistrimit, vendimi per sekuestrimin, akt ekspertimi teknik i shasise, shkresa drejtuar autoritetve gjermane te drejtesise.

Gjithashtu rezulton se me date 01.03.2012 nga ana e prokurorit eshte vendosur pushimi i procedimit penal Nr 633 te vitit 2011.

Neni 217 i Kodit Procedures Penale parashikon:

"1. Kur nuk eshte e nevojshme mbajtja e sekuestrimit per qellime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij qe i takojne edhe para se te merret vendimi perfundimtar".

Neni 218 i Kodit Procedures Penale parashikon:

"1. Gjykata vendos kthimin e sendeve te sekuestruara kur nuk ka dyshim mbi perkatesine e tyre.

3. Gjate hetimeve paraprake kthimi i sendeve te sekuestruara vendoset nga prokurori. Kunder ketij urdheri te interesuarit mund te behet ankim ne gjykate".

Kerkuesi megjithese kerkon lenien ne ruajtje te sendit nga pohimet dhe aktet nuk rezulton te kete paraqitur prova te cilat do ta conin gjykatën ne perfundimin se sendi i perket atij.

Gjithashtu megjithese i eshte drejtuar prokurorit me date 09.03.2012, pa pritur pergjigjen prej tij me date 12.03.2012 ka paraqitur kerkesen objekt gjykimi.

Neni 218/3 i K.Pr.Penale parashikon se kunder urdherit te prokurorit mund te behet ankim ne gjykate nga te interesuarit. Ne kushtet kur procedimi penal eshte pushuar pala kerkuese duhet te kerkoje zgjidhjen e kerkeses se saj duke u bazuar tek vendimi perkates i pushimit dhe disponimin e provave ne kete rast.

Ne keto rrethana perfundimisht Gjykata vlereson se kerkesa duhet te rrezohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të neneve 379 e vijues të K.Pr.Penale

VENDOSI

Rrezimin e kerkeses me nr 192 rregj qe i perket:

KËRKUES

OBJEKTI Kerkohet kthimi i sendit te sekuestruar, autovekture e markes BMW 730 pa targa me nr shasie sekuestruar shteta me procesverbalin e dates 30.05.2011 te o.p.g.

ME PJESËMARRJEN Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë si te pabazuar ne ligj dhe prova.

Shpenzimet gjyqesore sic jane kryer.

Kunder ketij vendimi mund te behet apelim ne Gjykatën e Apelit Vlore brenda 10 diteve nga e nesermja e shpalljes.

U shpall në Vlorë më datë 20.04.2012.

SEKRETARE
MARJANELA BESHTIKA



GJYQTAR
ALBERT SPIRO.



SHPENZIME GJYQESORE
Shpenzime kancelarie 500 leke

Gjithesej 500 leke.

Vendimi mori forme te prere me vendimin nr. 76 date 05.06.2012, te Gjykatës se Ape
qe ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit nr 192 date 20.04.2012 te Gjykatës se shkalles se Pare V
ketë mënyre :
- Pranimin e kerkeses. Kthimin e sendit te sekuestruar ,autoveture emarkes BMW 730
numer shasie [REDACTED] sipas procesverbalit te dates 30.05.2011 ,u
kërkuesit [REDACTED]

Vlore me 25.06.2012

KANCELARE
Irma DHIMITRIADHI

